VENDIM
Nr. 697, datë 22.10.2014

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVETË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "BY-PASS SHKOZET-PLEPA" (OBJEKTE)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "By-Pass Shkozet-Plepa" (objekte).

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për objekte me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 41 805 500 (dyzet e një milionë e tetëqind e pesë mijë e pesëqind) lekësh.

4. Vlera totale e shpronësimit prej 41 805 500 (dyzet e një milionë e tetëqind e pesë mijë e pesëqind) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2014, zëri shpronësime, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 113 000 (njëqind e trembëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZVRPP", të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë dhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Autoriteti Rrugor Shqiptar
Sektori i shpronësimeve

OBJEKTET QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË AKSIT "BY -PASS SHKOZET DURRES "

Lloji i pasurisë së paluajtshme:objekte

Nr.	Pronari			Z. K	Nr.		EMËRTIMI		
	Emri	Atësia	Mbiemri		Pas.	Vlera në lekë sipas preventivit	OBJEKTEVE	Shënim	Sip (m^2)
1	Feim		Shukulli	8515	5/840-ND-N1	**1,874,670**	Banesë	Konf. ZRPP	54
2	Zijet		Gjini	8516	17/77	**485,909**	Sistemime	Leje ndertimi	
3	Ferdinant		Dervishi	8515	5/2430	**5,287,936**	Banesë	Konf. ZRPP	248.5
4	Skender		Kapiti	8515	4/254	**5,735,160**	Banesë	Konf. ZRPP	110
5	Sulejman		Kapiti	8515	4/255	**6,809,603**	Banesë	Konf. ZRPP	140
6	Kadri		Delishi	8515	5/725	**2,907,686**	Banesë	Konf. ZRPP	25
7	Haxhi		Pupla	8515	5/738	**3,805,534**	Banesë	Konf. ZRPP	78.4
8	Limon		Lasku	8515	5/514-nd	**3,671,076**	Banesë	Konf. ZRPP	50
9	Gezim		Kurtbalaj	8515	5/631-N5	**2,936,248**	Banesë	Konf. ZRPP	113
10	Pranvera		Kurbalaj	8515	5/631 N-9	**2,753,449**	Banesë	Konf. ZRPP	112.5
11	Luftar		Kroburi	8515	5/816	**1,992,046**	Magazinë	Konf. ZRPP	40
	SHUMA					**41,805,500**			